



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 2 dt. 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.03.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt idesë për “Përgatitja e projektit të detajuar dhe dosjes së tenderit lidhur me punimet e restaurimit dhe konsolidimit të manastirit të Shën Mërisë në Apolloni. Gjatë hartimit të projekt zbatimit, projektuesit duhet të kenë parasysh pikat si më poshtë vijon:
 - Portiku i Statujave të restaurohet plotësisht.
 - Të zvogëlohet sipërfaqja e parkimit dhe të reduktohet kapaciteti i vendeve të parkimit në 70 makina dhe 10 autobusë.
 - Të ketë vetëm një hyrje-dalje për në park. Të mbahet vetëm hyrja në pjesën perëndimore të parkut, sipas propozimit në projekt ide.
 - Të mos realizohet sistemi i vaditjes në park.
 - Të realizohet kabina e re elektrike, për ndërtimin e së cilës të përdoret materiali i tullës.
 - Të hapet trapezaria dhe të bëhet i mundur ekspozimi, në depon arkeologjike.
 - Të përdoren tjegullat e vjetra për mbulimin e çatisë së kishës.
2. Miratohet “Projekt restaurimi Qela e kishës së Kuklit, Komuna Bushat, Shkodër. (Pjesë e kompleksit muzeor “Ndre Mjeda”).
3. Miratohet “Projekt restaurimi i ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Lushnjës”.

4. Miratohet në parim “Projekti i masterplanit të ndriçimit të zonës historike dhe projekti i zbatimit në zonë pilot, Gjirokastër”, për segmentin e Qafës së Pazarit. Të bëhet konsultë për përcaktimin e ndriçuesve në Kalanë e Gjirokastrës.
5. Lidhur me projektin e restaurimit dhe rikonstruksionit të kompleksit ish Kinostudio Shqipëria e Re” – ALBA FILM SH.A, për “Trajtimi i Xokolit të ndërtesës, ngjyra e mureve dhe dritareve si dhe problematika e statujave”, Miratohet:
 - Xokoli i ndërtesës të trajtohet sipas gjendjes ekzistuese në momentin e shpalljes së objektit monument kulture.
 - Kasat e dritareve të drurit të lyhen me ngjyrë të bardhë.
 - Fasada e objektit të lyhet ngjyrë e verdhë, sipas kodit të ngjyrës në momentin e shpalljes së objektit monument kulture. (Të konsultohet me IMK)
 - Statujat të restaurohen.
 - Të ngarkohet një specialist i sektorit të Artit, për kryerjen e sondazheve për pastrimin e medaljoneve në hyrjen kryesore të objektit, dhe supervizimin e resturimit të veprave të artit.
6. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO HURXHI



SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI

